



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA HAS**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Krume, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

Shtojca 12

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT (PARAPRAK)**

[Data 08.07.2024]

Drejtuar: “NIEM” sh.p.k., *Korce, Qender Bilisht, autostrada Bilisht - Korce , Km 3, Bitincke.*

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedure e hapur – pune**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-05177-05-17-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Rehabilitim trotuare pergjate rruges nacionale dalje Qytetit Krume deri Rezervuari Pla”**,

Afati: 60 Dite nga momenti i nenshkrimit të kontratës.

Publikimet e mëparshme: Nuk ka patur.

Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 27 datë 27 Maj 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE MURATI & LIS KONSTRUKSION & LLUCA shpk

J66702413V /  
K66613407H /  
K29824105N

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-t*

Vlera 14,690,970 ( *Katermbedhjete milion e gjashteqind e nentedhjete mije e nenteqind e shtatedhjete* ) *Leke pa t.v.sh.*

2. ZDRAVA shpk

J84003411K

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera 16,716,000 ( *Gjashtembedhjete milion e shtateqind e gjashtembedhjete mije* ) *Leke pa t.v.sh.*

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

3. LIQENI VII sh.p.k.

K01730502W

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera 15,586,200 ( *Pesembedhjete milion e peseqind e tetedhjete e gjashte mije e dyqind* ) *Leke pa t.v.sh.*

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

4. ASI-2A CO shpk

K53002402C

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera 13,999,776 ( *Trembedhjete milion e nenteqind e nentedhjete e nente mije e shtateqind e shtatedhjete e gjashte* ) *Leke pa t.v.sh.*

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

5. RSM COMPANY shpk

L04803001U

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera 14,697,900 ( *Katermbedhjete milion e gjashteqind e nentedhjete e shtate mije e nenteqind* ) *Leke pa t.v.sh.*

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

6. BOE MARSI & MELA shpk

J68028214P /

K62320011G

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera 15,724,748 ( *Pesembedhjete milion e shtateqind e njetete e kater mije e shtateqind e dyzete e tete* ) *Leke pa t.v.sh.*

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

7. NIEM shpk

K36609610Q

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera 17,601,990 ( *Shtatembedhjete milion e gjashtëqind e nje mije e nenteqind e nentedhjete* )  
*Leke pa t.v.sh.*

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

8. 2 N shpk

L31615017L

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera 14,000,044 ( *Katermbedhjete milion e dyzete e kater* ) *Leke pa t.v.sh.*

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

9. BOE Haziri & Avduli sh.p.k.

J66702916G /

J66703306O

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera 16,176,300 ( *Gjashtembedhjete milion e njeqind e shtatedhjete e gjashte mije e treqind* )  
*Leke pa t.v.sh.*

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

10. KTHELLA shpk

J69303023D

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera 13,817,346 ( *Trembedhjete milion e teteqind e shtatembedhjete mije e treqind e dyzete e gjashte* ) *Leke pa t.v.sh.*

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

11. XHAAS shpk

K12512837I

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera 17,530,611 ( *Shtatembedhjete milion e peseqind e tridhjete mije e gjashtëqind e njembedhjete* ) *Leke pa t.v.sh.*

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

12. SENKA shpk

J94808405Q

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera 19,799,535 ( *Nentembedhjete milion e shtateqind e nentedhjete e nente mije e peseqind e tridhjete e pese* ) *Leke pa t.v.sh.*

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

13. BOE VISCONS GROUP & ICC GROUP

L96513208E /

L51308006A

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera 14,898,975 ( *Katermbedhjete milion e teteqind e nentedhjete e tete mije e nenteqind e shtatedhjete e pese* ) *Leke pa t.v.sh.*

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE MURATI & LIS KONSTRUKSION & LLUCA shpk

J66702413V /  
K66613407H /  
K29824105N

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-t*

Per arsyet e mëposhtme:

➤ Se pari, shoqëria “Lluca” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, konkretisht, pika:

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit **2021, 2022, 2023** të konfirmuara me vule pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomike të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e gërmes “c” të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve, të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Ky operator ekonomik ka paraqitur bilancet për vitet 2021, 2022, 2023 të pa konfirmuara nga organet tatimore. Gjithashtu, nuk ka paraqitur raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve.

➤ Se dyti, shoqëria “Lluca” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, konkretisht, pika:

**2.3.7** Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- Çertifikate ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Çertifikate ISO 14001-2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Çertifikate ISO 45001-2018 “Për Sistemin e Menaxhimit të Shendetit dhe Sigurimit në Pune”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

Nëse çertifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto çertifikata të jenë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga Organizmat Nderkombetare Akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast Bashkimi të Operatorëve Ekonomikë, secili Operator Ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marre përsiper të realizojë, referuar kontratës së bashkepunimit të nënshkruar.

Certifikatat Iso të paraqitura nga shoqëria “Lluca” sh.p.k. kanë datë skadimi 12.09.2023.

- Se treti, shoqëria “Lis Konstruksion” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, konkretisht:

Shoqëria “Lis Konstruksion” sh.p.k, rezulton se për këtë procedurë prokurimi ka paraqitur mjetin me të dhenat si më poshtë:

Autobetoniere me targa AA513NR, Leje Qarkullimi DRD0661516 shasia WJM4CP800C066479 NR 2981 REP NR 2349 KOL 24.05.2023 24.05.2025

I njejtë mjet është paraqitur edhe nga shoqëria “Liqeni VII” sh.p.k:

Autobetoniere me targa AA513NR, Leje Qarkullimi DRD0661516 shasia WJM4CP800C066479 NR 13326 REP NR 5406 KOL 13.07.2023 13.07.2028

2. LIQENI VII sh.p.k.

K01730502W

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Per arsyet e mëposhtme:

- Operatori ekonomik “Liqeni VII” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, konkretisht, pika:

### 2.3.4 Makineri Pajisje

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme, të cilat **duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera**, të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës:

| Nr | Lloji i makinerive | Njësia | Sasia | Statusi                |
|----|--------------------|--------|-------|------------------------|
| 5  | Autobetoniere      | cope   | 1     | Ne pronesi ose me qira |

Kriteri konsiderohet i përmbushur me *plotësimin e Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8*. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

Për mjetet që shenohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit (certifikate pronësie), leje qarkullimi, certifikata e kontrollit teknik SGS, siguracionin e mjetit, taksat vjetore, leja e transportit si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe të jetë e dukshme targa e mjetit. Për mjetet e siguruar me qera, të paraqiten dokumentet sa me sipër sidhe kontrata e qerave.

Për mjetet e tjera që nuk janë të shenuara në regjistrat publike duhet të paraqitet kontrate noteriale e blerjes apo çdoganimit, fature tatimore, foto.

Shoqëria “Liqeni VII” sh.p.k. për plotësimin e këtij kriteri ka paraqitur:

Autobetoniere me targa AA513NR, Leje Qarkullimi DRD0661516 shasia WJMJ4CP800C066479 NR 13326 REP NR 5406 KOL 13.07.2023 13.07.2028

I njejtë automjet është paraqitur për këtë procedurë prokurimi edhe nga shoqëria “Lis Konstruksion” sh.p.k, konkretisht:

Autobetoniere me targa AA513NR, Leje Qarkullimi DRD0661516 shasia WJMJ4CP800C066479 NR 2981 REP NR 2349 KOL 24.05.2023 24.05.2025

Sic vërehet, në momentin kur shoqëria “Liqeni VII” sh.p.k. ka nënshkruar kontratën e qerasë, mjeti tip “Autobetoniere” ka qenë tashmë me qera nga shoqëria “Lis Konstruksion” sh.p.k, duke e bërë të pamundur disponimin e këtij mjeti.

3. ASI-2A CO shpk

K53002402C

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Per arsyet e meposhtme:

Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se oferta e paraqitur nga OE eshte oferte anomalisht e ulet, pasi ky OE ka paraqitur oferte me te ulet se 25% e fondit limit oferta e paraqitur eshte ulur 30% e fondit limit dhe me te ulet se 85% e mesatares se ofertave (te kualifikuara), si dhe per KVO-ne, kjo anomali verehet e dyshimte (e papergjegjshme) duke qene se çmimet e materialeve te ndertimit kane pesuar nje rritje te konsiderueshme ne treg dhe për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “për prokurimin publik” nr. 16/2024.

KVO thekson se bazuar ne piken 4, te nenit 82, te VKM-se 285, date 19.05.2021 dhe ligjit Nr. 16/2024 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se;

“Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;
- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Neni 27

Në nenin 93 pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”

Ne kete rast autoriteti kontraktore bazuar ligjit te prokurimit publik refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët, më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme oferten e paraqitur nga shoqeria ASI-2A CO Shpk.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet

kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e shoqërisë ASI-2A CO Shpk, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

4. RSM COMPANY shpk

L04803001U

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Per arsyet e mëposhtme:

Shoqëria “RSM COMPANY” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, konkretisht, pika:

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

d. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 2;

Ky operator ekonomik ka paraqitur ofertën ekonomike me ndryshime të mëdha në sasinë e preventivit të prokuruar nga autoriteti kontraktor.

5. BOE MARSİ & MELA shpk

J68028214P /

K62320011G

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Per arsyet e mëposhtme:

➤ Se pari, bashkimi i operatoreve ekonomike “Marsi” sh.p.k. & “Mela” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e përgjithshme për kualifikim, konkretisht:

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

➤ Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.



Sipas akt marrëveshjes së paraqitur për këtë procedure prokurimi, rezulton:

Shoqëria “Mela” sh.p.k. 35%

Shoqëria “Marsi” sh.p.k. 65%

Ky BOE nuk ka përcaktuar elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit, në kundërshtim me kërkesat e përgjithshme për kualifikim.

- Se dyti, shoqëria “Marsi” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, konkretisht, pika:

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit **2021, 2022, 2023** të konfirmuara me vule pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomike të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e gërmes “c” të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve, të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Nuk ka paraqitur raportin e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancin e vitit 2021.

- Se treti, bashkimi i operatoreve ekonomike “Marsi” sh.p.k. & “Mela” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, konkretisht:

**2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:**

c) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës inxhinierik** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në liçencën e shoqërisë), si më poshtë:

Inxhinier Strukturist

1 (një)

Për plotësimin e këtij kriteri, në formularin e vetedeklarimit ky bashkim operatorësh ekonomik ka paraqitur Inxhinier Ndertimi. Referuar kërkesave të vecanta për kualifikim, rezulton se janë kërkuar profile të ndryshme të personelit të kualifikuar inxhinierik, dhe se profili inxhinier ndertimi dhe inxhinier strukturist janë profile të ndryshme.

- Se katerti, bashkimi i operatoreve ekonomike “Marsi” sh.p.k. & “Mela” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, konkretisht:

### 2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponoje në pronesi / qira:

- 1 (nje) Impiant prodhimi Betoni

Për impiantin e prodhimit të betonit, duhet të paraqiten dokumente që vertetojnë pronesine e saj, (Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion që verteton pronesine. Në rast se impianti i prodhimit të betonit është me qera duhet të paraqitet kontrata e qerave.

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

Asnjëri nga anetaret e bashkimit të operatoreve ekonomike nuk ka plotësuar në formularin e vetedeklarimit shtojca 8 se disponon në pronësi apo me qera Impiant prodhimi Betoni.

6. 2 N shpk

L31615017L

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Per arsyet e meposhtme:

Ky operator ekonomik nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, konkretisht:

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

d. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 2;

Pasi, këto dokumenta janë paraqitur për procedurë tjetër prokurimi, jo sipas kësaj procedurë prokurimi, është paraqitur i ndryshem numri i references.

7. BOE Haziri & Avduli sh.p.k.

J66702916G /

J66703306O

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Per arsyet e meposhtme:

- Së pari, shoqëria “Avduli” sh.p.k. nuk ka plotësuar sakte Formularin e Vetedeklarimit sipas Shtojca 8, pasi ka deklaruar në formularin e Vetedeklarimit se ka paraqitur oferte të pavarur dhe njëkohesisht ka deklaruar se merr pjese në këtë procedurë prokurimi si bashkim operatorësh ekonomik me shoqëria “Haziri” sh.p.k.
- Së dyti, shoqëria “Haziri” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim, pika **2.2.2**. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit **2021, 2022, 2023** të konfirmuara me vule pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomike të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e gërmes “c” të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve, të konfirmuara nga administrata tatimore. Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Shoqëria “Haziri” sh.p.k. nuk ka të konfirmuara Bilancet për vitet 2021, 2022 dhe 2023.

- Së treti, shoqëria “Haziri” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim, pika

### **2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:**

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

#### **Ose**

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*).

### **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.**

2.3.1/a Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formularin e vlerësimit sipas Shtojcës 9;
- Kontratën e sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;

- Faturat tatimore;
- Akti i Kolaudimit

2.3.1/b Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë sipermarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore;
- Leje për kryerjen e punimeve

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Kontrata me objekt “Ndertim rruge Malore qender fshati Gjinaj – Stanet, Bjeshka Gjinaj dhe Rikonstruksion rruges Gjinaj – Pus I Thate” është paraqitur fotokopje pa ngjyra, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në Dokumentat Standarte të Tenderit:

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s`kualifikim.**

Për kontratën e paraqitur me objekt “Ndertimi i terreneve Sportive prane Shkolles 9-vjecare Xhevdet Doda”, nuk plotëson vlerën e kërkuar sipas përqindjes në këtë procedurë prokurimi, pasi ka marr përsipër 68.867% të përfaqësimit.

➤ Së katërti, shoqëria “Haziri” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim, pika **2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:**

a) Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë një punësim mesatar të paktën 35 ( Tridhjetë e pesë ) punonjës duke përfshirë dhe stafin teknik, për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të

vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën e mësipërme në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nëpërmjet formes elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Ne formularin e vetedeklarimit Shtojca 8, ka përcaktuar numrin e punonjësve që disponon për periudhën e kërkuar: Shkurt -17 Punonjes, Mars 21 -Punonjes, Prill- 20 Punonjes.

Perqinda e përfaqësimit referuar numrit të punonjësve të vetedeklaruar në formularin përkatës, që ploteson ky operator ekonomik është 55.24%, kurse sipas marreveshjes së bashkepunimit ka marr përsiper 68.867%.

➤ Së pesti, shoqëria “Haziri” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim, pika

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të disponoje në pronesi / qira:

➤ 1 (nje) Impiant prodhimi Betoni

Për impiantin e prodhimit të betonit, duhet të paraqiten dokumente që vertetojnë pronesine e saj, (Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion që verteton pronesine. Në rast se impianti i prodhimit të betonit është me qera duhet të paraqitet kontrata e qerave.

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

Shoqëria “Haziri” sh.p.k. nuk ka deklaruar se disponon impiant prodhimi betoni në pronesi apo me qera, pamvarsisht faktit se ka marr përsiper realizimin e zerit të punimeve “Struturë monolite betoni C12/15”.

- Së gjashti, bashkimi i operatoreve ekonomike “Haziri” sh.p.k. & “Avduli” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim, pika:

### **2.3.6 Operatori ekonomik në rast se nuk është prodhues duhet të paraqese kontrate furnizimi për materialet pllaka trotuari.**

Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin / aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Asnjëri nga përfaqësuesit e këtij bashkimi operatorësh ekonomik nuk ka paraqitur në formularin e vetedeklarimit Shtojca 8 që ka në pronesi apo me kontrate furnizimi për materialet pllaka trotuari.

8. KTHELLA shpk  
*Emri i plotë i shoqërisë*

J69303023D  
*Numri i NIPT-it*

Per arsyet e meposhtme:

- Se pari, nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim, sipas pikës **2.3.6 Operatori ekonomik në rast se nuk është prodhues duhet të paraqese kontrate furnizimi për materialet pllaka trotuari.**

Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin / aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Ky operator ekonomik nuk ka deklaruar në Formularin e Vetedeklarimit Shtojca 8 se disponon në pronesi / me kontrate furnizimi materialet pllaka trotuari.

Gjithashtu, ka paraqitur fotokopje nje kontrate furnizimi date 03.06.2024, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në Dokumentat Standarte të Tenderit:

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s`kualifikim.**

- **Se dyti**, ky operator ekonomik për plotësimin e kriterëve të veçanta pika 2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronesi / qira:

- 1 (nje) Impiant prodhimi Betoni

Për impiantin e prodhimit të betonit, duhet të paraqiten dokumente që vertetojnë pronesine e saj, (Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion që verteton pronesine. Ne rast se impianti i prodhimit të betonit është me qera duhet të paraqitet kontrata e qerase. *Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".*

Për plotësimin e këtij kriteri, ky operator ekonomik ka paraqitur kontratën e furnizimit Nr. 4090 Rep. Nr. 2404 Kol. datë 25.07.2020 me furnizuesin Shoqëria A - KLAS - BETON ASFALT.

Shoqëria A - KLAS - BETON ASFALT sipas Ekstraktit të Historikut të kësaj kompanie, rezulton se ka të vendosura masat e sekuestros si vijon:

Numri i ceshtjes: CN-613432-03-16 Arsytet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i urdhrit Nr.2133, datë 21.03.2015, lëshuar nga Shoqëria Përmbartimore ESPA është urdhëruar: Vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi aksionet e palës debitore, subjekti "A - KLAS - BETON ASFALT" shpk me NUIS (NIPT)K78409501N, dhe nga te drejtat që rrjedhin nga zoterimi i ketyre 8 kuotave.

Numri i ceshtjes: CN-130918-01-17 Arsytet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i urdhrit Nr.518 Prot., datë 25.01.2017, protokolluar nga Qkb me Nr. 1099, dt. 25.01.2017, lëshuar nga Shoqëria Përmbartimore ESPA është urdhëruar: Bllokimin e kuotave/ aksioneve dhe e te drejtave që rrjedhin nga zoterimi I kuotave për palën debitore, subjekti "A - KLAS - BETON ASFALT" shpk me NUIS (NIPT)K78409501N

Numri i ceshtjes: CN-663866-02-18 Arsytet e hapjes se ceshtjes: Depozitim i urdhrit Nr.733 Prot., datë 05.02.2018, lëshuar nga Përmbartuesi Gjyqësor Privat "Ermir Godaj", ku është urdhëruar: Vendosja e masës së sekuestros konservative mbi kapitalin që zoteron debitori shoqëria "A - KLAS - BETON ASFALT" sh.p.k, me NUIS (NIPT) - K78409501N, në mënyrë që të mos kryhet asnjë veprim tjetërsimi apo disponim

Numri i ceshtjes: CN-875526-03-22 Arsytet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i shkresës Nr.69//5Prot., datë 23.02.2022, për Vendosjen e Masës së Sigurimit të detyrimit tatimor, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Rajoni Verior, Shkoder, ku është kërkuar: Vendosjen e Barres Siguruese mbi titujt e Pronesise në mënyrë që të mos kryhen veprime tjetërsimi ndaj ketyre titujve për tatimpaguesin "A - KLAS - BETON ASFALT" shpk pajisur me NUIS (NIPT)- K78409501N.

Numri i ceshtjes: CN-187537-08-23 Arsytet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i shkresës Nr. 642/5 Prot, datë 02.08.2023 për Vendosje të Masës së Sigurimit të Detyrimit Tatimor, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Rajoni Verior, ku është kërkuar: Vendosje të masës së

sigurimit të detyrimit tatimor, mbi tatimpaguesin shoqëria “ A - KLAS - BETON ASFALT ” SH.P.K., pajisur me NUIS (Nipt)- K78409501N. Vendosja e kësaj masë synon të moslejohet tjetërsimi i titujve të pronësisë dhe të drejtat pasurore që i përkasin këtij tatimpaguesit deri në shlyerjen e detyrimeve tatimore.

➤ **Se treti, referuar ekstraktit të historikut tregtar të kompanise “KTHELLA” shpk, me NIPT J69303023D, rezulton se mbi aksionet dhe pasurite e paluajtshme të këtij operatori ekonomik është vendosur sekuestro konservative në dy raste, konkretisht:**

- Me datë 07.06.2024: Numri i ceshtjes: CN-297983-06-24 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i urdhrimit nr. 370/1 Prot, Nr. 2569/1 Dosje datë 06.06.2024, lëshuar nga Zyra e Përmbartimit “ TDR GROUP ” , nga Përmbartuesi Gjyqësor Privat Florian Shehu, ku është urdhëruar: Vendosja e sekuestros konservative mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga shoqëria “KTHELLA ” SHPK, me NIPT - J69303023D.
  
- Me datë 19.04.2024: Numri i ceshtjes: CN-275329-04-24 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i urdherit Nr.1016 Prot.,Nr.2188 Regj date 15.04.2024, lëshuar nga Zyra e Përmbartimit Private Real Bailiff Service ku është urdhëruar: “Vendosja e mases se sekuestros konservative mbi pasuritë e paluajtshme ne pronesi te debitorit, “ KTHELLA ” SHPK, pajisur me NUIS(NIPT)- J69303023D me qellim mostjetersimin e tyre, si dhe moskryerjen e cdo veprimi qe do sillte ndryshime ne regjistrin tregtar.

9. XHAST shpk  
*Emri i plotë i shoqërisë*

K12512837I  
*Numri i NIPT-it*

Per arsyet e meposhtme:

- Se pari, shoqëria “Xhast” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, konkretisht, pika:

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

d. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 2;

Ky operator ekonomik ka paraqitur ofertën ekonomike me ndryshime të mëdha në sasi të preventivit të prokuruar nga autoriteti kontraktor.



Per arsyet e mëposhtme:

- Se pari, bashkimi i operatoreve ekonomike shoqëria “Viscons Group” sh.p.k. & “ICC Group” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e përgjithshme për kualifikim, konkretisht, pika:

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

Sipas Akt Marrëveshjes së bashkëpunimit, është bërë ndarja e përqindjeve:

Ndarja e përqindjeve është si më poshtë:

1. Shoqëria “**VISCONS GROUP**” sh.p.k , 10 % të pjesëmarrjes
2. Shoqëria “**I.C.C GROUP**” sh.p.k , 90 % të pjesëmarrjes

Sipas preventivit të punimeve është bërë ndarja për secilin ze punimesh dhe rezulton se përqindja është 50% / 50 %.

Kemi mospërputhje ndërmjet ndarjes në përqindje në akt marrëveshjen e bashkëpunimit me preventivin e ndarjes së punimeve.

- Se dyti, shoqëria “ICC Group” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, konkretisht, pika:

**2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:**

- b)** Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë një punësim mesatar të paktën 35 ( Tridhjetë e pesë ) punonjës duke përfshirë dhe stafin teknik, për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën e mësipërme në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”*. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:
  - Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.

- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nëpërmjet formes elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Sipas Akt Marreveshjes se bashkepunimit, është bërë ndarja e përqindjeve:

Ndarja e përqindjeve është si me poshte:

1. Shoqëria “**VISCONS GROUP**” sh.p.k , 10 % te pjesëmarrjes
2. Shoqëria “**I.C.C GROUP**” sh.p.k , 90 % te pjesëmarrjes

Shoqëria ”ICC Group” sh.p.k. nuk plotëson përqindjen e deklaruar në akt marreveshje 90%, pasi ka deklaruar në formularin e Vetedeklarimit Shtojca 8, se disponon 30 punonjes.

- Se treti, shoqëria “ICC Group” sh.p.k. nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, konkretisht, pika:

### **2.3.6 Operatori ekonomik në rast se nuk është prodhues duhet të paraqesë kontratë furnizimi për materialet pllaka trotuari.**

Në rast paraqitje kontratë furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin / aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Shoqëria ”ICC Group” sh.p.k. nuk ka deklaruar në formularin e vetedeklarimit shtojca 8 për furnizimin me pllaka trotuari, kurse sipas ndarjes së punimeve ka marrë përsipër realizimin e zërit: F+V trotuar me pllaka me shtresë 6 cm beton – 1680 m<sup>2</sup>.

**Operatori ekonomik ZDRAVA shpk duhet të dorëzonte pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin e parashikuar në pikën 6 të nenit 26 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1 të LPP-së.**

**Pas mbarimit të afatit të përcaktuar në njoftimin e autoritetit kontraktor është bërë ri-vlerësimi në sistemin e prokurimit.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “NIEM” sh.p.k., Korce, Qender Bilisht, autostrada Bilisht - Korce , Km 3, Bitincke, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 17,601,990 ( Shtatembedhjetë milion e gjashtëqind e nje mijë e nentëqind e nentëdhjetë ) Leke pa t.v.sh. / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.